



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/323  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202300331/17

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023

**Lënda:** Rekomandohet marrja e masave për parandalimin e rasteve të vdekjeve të burgosurve për shkak të neglizhencës së stafit të IEVP dhe të vlerësimit më saktë të rrezikut për gjendjen shëndetësore që paraqet një i burgosur.

**Drejtuar:** DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE  
TIRANË

INSTITUCIONIT TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

JORDAN MISJA TIRANË

*Të nderuar,*

Në datë 01.04.2023, në media është bërë publik lajmi, se në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale "Jordan Misja", Tiranë, i paraburgosuri Renalt Tahiri, dyshohet se ka ndërruar jetë në spital, si pasojë e një arresti kardiak. Mësohet se viktimi ishte 37 vjeç dhe ishte i paraburgosur nën akuzën e veprave penale "Vjedhje" dhe "Prodhim dhe shitje të narkotikëve" arrestuar me datë 27.03.2023, nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë dhe ardhur në IEVP "Jordan Misja", Tiranë më datë 31.03.2023<sup>1</sup>.

Me marrjen dijani të këtij lajmi, Institucioni i Avokatit të Popullit në përmbushje të misionit të tij kushtetues e ligjor për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, nga veprimet dhe mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, ngriti grupin e punës, me qëllim verifikimin e situatës në vend, si dhe intervistimin e bashkëvuajtësve dhe të stafit të IEVP "Jordan Misja", Tiranë në lidhje me ngjarjen e rëndë të ndodhur në këtë institucion.

Për të kuptuar nëse kjo ngjarje mund të parandalohet janë kryer veprimet hetimore si vijon: marrja e shpjegimeve nga i burgosuri, shok dhome me Renalt Tahiri; këqyrja e librit të

<sup>1</sup> <https://dosja.al/aktualitet/i-riu-vdiq-ne-qeli-reagon-pas-6-ditesh-drejtoria-e-burgjeve-konsumont-i291227>

pritjes së të dënuarve, informacioni nga I EVP “Jordan Misja”, pamjet filmike; këqyrja kartelës klinike mjekësore nr.4455 të datës 31.03.2023 të të paraburgosurit Renalt Tahiri; administrimin e akt-ekspertimit nr.159 prot, datë 02.04.2023 dhe administrimin e korrespondencave me institucionet përgjegjëse.

Sipas materialit të mbledhur rezulton se gjendja shëndetësore e shtetasit Renalt Tahiri në paraqitjen e tij në I EVP “Jordan Misja”, Tiranë, në orën 12:40 minuta të datës 31.03.2023 dhe në paraqitjen e tij para Komisionit të Pranimimit, si dhe gjatë kalimit të tij në dhomë, ku është akomoduar në dhomën nr.4, kati 1 në Sektorin e Obeservimit, Godina A, me të paraburgosurin Vasil Lera ka qenë në parametra jo të mira shëndetësore.

Në këtë situatë, duke parë gjendjen e tij të rënduar shëndetësore, po atë ditë, në orën 14:02 min është bërë shoqërimi i tij me ambulancë në Qendrën e Spitalit të Burgjeve, nga specialisti i Regjimit të Jashtëm bashkë me grupin e sigurisë të DPB.

Në vijim, i paraburgosuri Renalt Tahiri, është kthyer nga Qendra e Spitalit të Burgjeve në I EVP “Jordan Misja”, Tiranë, në orën 14:45 minuta dhe më pas është vazhduar me shoqërimin e tij në dhomën nr.4, kati i parë në Sektorin e Observimit, godina A.

Gjithashtu, sipas informacionit të drejtuesve të institucionit, në datë 01.04.2023 në orën 22:00 janë kontaktuar nga specialisti i informacionit z. Zog Muhametaj, i cili u ka bërë me dije ngjarjen mbi gjendjen shëndetësore të rënduar të të paraburgosurit Renalt Tahiri dhe më pas është bërë shoqërimi i menjëhershëm i tij në urgjencën e QSUT.

Sipas regjistrave përkatës është dhënë ndihma e parë që në akomodimin e të paraburgosurit në dhomën nr.4, kati 1 në Sektorin e Obeservimit, Godina A të I EVP “Jordan Misja”, Tiranë në mënyrë të vazhdueshme dhe deri në shoqërimin e tij në QSUT, ku mësohet se ka ndërruar jetë.

Sipas deklarimeve të bashkëvuajtësit të të paraburgosurit Renalt Tahiri, shtetasi Vasil Lera referon se me datë 31.03.2023 ka ardhur në dhomë shtetasi Renalt Tahiri, i cili është akomoduar në shtratin e tij, ku gjatë gjithë kohës rënkonte për dhimbje të forta në stomak dhe gjendje jo të mirë shëndetësore. Sipas tij, në mënyrë të vazhdueshme ai ka marrë qetësues nga ndihmës mjeku i turnit, por vijonte me dhimbje dhe kriza të forta shëndetësore.

Ndërkohë, sipas pamjeve filmike, të datës 31.03.2023, në kamerën e sigurisë me nr.169, shikohet se në orën 12:40, i paraburgosuri Renalt Tahiri, është paraqitur para Komisionit të Pritjes të këtij institucioni. Në kamera duket që personi pasi kalon kontrollin fizik nga punonjësit e policisë dhe kalimin në skaner, qëndron para Komisionit të Pritjes dhe shfaq probleme shëndetësore, pasi nuk qëndron dot në këmbë dhe kërkon një stol që të qëndrojë ulur. Përveç përfaqësuesit të sektorit juridik, të sektorit të çështjeve shoqërore, në Komisionin e Pritjes është prezente edhe mjekja e institucionit (shefe e Sektorit të Shëndetësisë). Gjithashtu, në **orën 12:50**, i paraburgosuri kalon përsëri në skaner dhe shoqërohet për në dhomat e observimit të institucionit. Ndërkohë, në kamerën nr. 173, në **orën 14:02**, i paraburgosuri ka shfaqur probleme shëndetësore dhe nën shoqërimin e mjekes dhe shefit të policisë të institucionit, pasi kalon nga dhomat e observimit, kryen kontrollin fizik dhe shoqërohet me urgjencë me ambulancën e institucionit për në QSB (Spitali i Burgjeve), Tiranë, ku kthehet në orën **15:44** nga vizita mjekësore. Pas ardhjes në

institucion, ai kryen kontrollin fizik nga punonjësit e policisë dhe hyn në dhomat e observimit.

Ky rast tregon se, Komisioni i Pritjes së të dënuarve dhe të paraburgosurve nuk ka qenë i kujdesshëm në vlerësimin dhe pranimin e shtetasit në këtë institucion. Gjendja shëndetësore e shtetasit ka qenë në dukje tepër e rënduar dhe mund të shërbente si informacion për personelin e burgut për të kuptuar se kemi të bëjmë me pranimin e një të paraburgosuri me probleme të rënduara shëndetësore. Nga këqyrja e librit të pritjes së të dënuarve dhe të paraburgosurve të datës 31.03.2023 shënohet se: “Gjendja shëndetësore e të paraburgosurit Renalt Tahiri është jo e mirë, apatike dhe me dobësi trupore”. Nga këqyrja e kartelës klinike nr. 44555, datë 31.03.2023 konstatohet se i paraburgosuri për veç të tjera, ka referuar se ka vite që është përdorues i lëndëve narkotike, dhe si rrjedhojë ka vuajtur nga hepatitis AB dhe C, si dhe trajtohet me metanon 60 mg. Po ashtu, nga ekzaminimi objektiv paraqet lëkurë dhe membrana të zbehta, fytyrë të mprehtë dhe të zbehtë, sytë që hapen me vështirësi, vetëdije e ruajtur. Me diagnozë toksikoman, ku janë bërë konsulta me psikiatër, dhe konsulta me toksikolog.

Referuar ligjit nr.81, datë 25.06.2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, në nenin 41, pika 14 thuhet se raste urgjence, kur rrezikohet jeta e të burgosurit, ai transferohet për mjekim në Qendrën Spitalore të Burgjeve ose në institucionet e Kujdesit Shëndetësor Rajonal. Ndërsa në nenin 42, pika 7 të këtij ligji parashikohet se të burgosurit që shfaqin shenja të përdorimit të drogës, të substancave psikotrope, alkoolit ose shfaqin shenja të stresit u nënshtrohen të njëjtave programe shëndetësore dhe sociale që zbatohen jashtë institucionit.

Sipas legjislacionit në fuqi, shërbimi shëndetësor për të burgosurit sigurohet gjatë gjithë kohës së qëndrimit në IEVP. Administrata e institucionit siguron kushtet, mjetet dhe personelin për mbrojtjen e shëndetit të të burgosurve. Në rastin konkret kemi pasur një neglizhim apo mosveprim të shpejtë nga ana e Komisionit të Pritjes të IEVP-së “Jordan Misja”, Tiranë, pasi i paraburgosuri duhet të ishte trajtuar në regjim spitalor, si pasojë e shëndetit tepër të rënduar të tij.

Avokati i Popullit sjell në vëmendjen tuaj qëndrimet e KPT-së (CPT-së) në lidhje me vonesën e qasjes të të burgosurve te mjeku specialist, ku rekomandon se: *“Derisa qëndrojnë në burg, personave të burgosurit duhet tu mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre” dhe se, “shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”,* si dhe Rregulloren Evropiane të Burgjeve ku përcaktohet se: *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”<sup>2</sup>.*

Nga mbikëqyrja e ambientit të dhomës nr.4, me sipërfaqe 4m<sup>2</sup>, ku i paraburgosuri ka qëndruar për një ditë, konstatohet se dritarja e kësaj dhome ishte me përmasa jo të mjaftueshme dhe nuk mundësonte futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe të dritës natyrale. Nga vlerësimi i kushteve materiale të institucionit, ato nuk janë sipas parametrave teknike jetësore të përcaktuar në legjislacionin kombëtar dhe atë ndërkombëtar. Vlen të

---

<sup>2</sup> Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

theksojmë se Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) shprehet se norma minimale e hapësirës për person, në institucione të tilla është 6 m<sup>2</sup> për dhomat për një person dhe 4 m<sup>2</sup> kur në to sistemohen më shumë persona. Në këtë normë nuk mbahet parasysh sipërfaqja e tualetit, që mund të ndodhet brenda dhomës. Gjithashtu, sipas standardit të Komitetit për Parandalimin e Torturës, duhet respektuar dhe distanca ndërmjet mureve të dhomave, që duhet të jetë jo më pak se 2 m distancë ndërmjet mureve të dhomës dhe jo më pak se 2.5 m distancë nga dyshemeja me tavanin e dhomës, sikurse përcaktohet dhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Ndërkohë, nga inspektimi ishte evident fakti që, infrastruktura e këtij institucioni nuk ofronte asnjë kusht dhe standard ligjor, pasi godina ishte gjysmë nëntokë dhe me nivel të lartë lagështire, ku të paraburgosurit mbaheshin si në bodrum, duke e bërë trajtimin e tyre jo human dhe degradues.

Sipas konstatimeve në dhomën e të paraburgosurit thuajse mungonte ajrimi dhe drita natyrale, pasi përmasat e dritareve të dhomës ishin shumë të vogla dhe nuk e lejonin hyrjen e ajrit dhe dritës natyrale. Gjithashtu, problematika të tjera konsistonin në prezencën e lagështirës në dhomën e banimit, dhe mungesën e sistemit qendror për ngrohje/ftohje, për t'iu përshtatur kushteve klimaterike, edhe pse nga Institucioni i Avokatit të Popullit janë bërë rekomandime të përsëritura në lidhjet në kushtet në këtë godinë, por ky rekomandim ndonëse i pranuar por nuk është zbatuar nga ky institucion për mungesë fondesh.

Në kuadër të hetimit administrativ, nga ana jonë i është kërkuar informacion dhe dokumentacion Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë<sup>3</sup>, Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë<sup>4</sup>, Spitalit Universitar të Traumës<sup>5</sup>, Institucionit të Mjekësisë Ligjore<sup>6</sup>, Qendrës Spitalore të Burgjeve<sup>7</sup> dhe Prokurorisë së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë<sup>8</sup>.

Drejtorja Vendore e Policisë Tiranë na informon me shkresën nr. 4173, datë 13.04.2023, ndër të tjerat se shtetasi Renalt Tahiri është arrestuar nga specialistët e krimeve të Komisarariatit të Policisë nr.3 Tiranë, më datë 27.03.2023 për veprën penale të vjedhjes dhe është akomoduar në orën 05:00 në dhomat e “bllokut të sigurisë”, të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë. Gjithashtu, u informuam se shtetasi nga momenti i pranimit në dhomat e sigurisë dhe deri në momentin e transferimit është mbajtur nën mbikëqyrjen e vazhdueshme nga shërbimet e sigurisë pasi ishte përdorues i lëndëve narkotike dhe po trajtohej me 60 mlg metadon në ditë. Po ashtu, u informuam se gjatë periudhës së qëndrimit në dhomat e sigurisë shtetasi Renalt Tahiri ka kërkuar mjekun për vizitë, ku është njoftuar urgjenca e Spitalit “Nënë Tereza” Tiranë dhe mjekët i kanë dhënë mjekimin e nevojshëm.

Ndërsa Qendra Spitalore “Nënë Tereza” Tiranë (QSUT) me shkresën nr.843/3 prot, datë 19.04.2023, si dhe shkresën me nr. 843/8 prot, datë 12.06.2023, na informon se i paraburgosuri Renalt Tahiri nuk rezulton të jetë paraqitur pranë QSUT në datën 01.04.2023, por sipas përgjigjes së këtij institucioni shtetasi në fjalë rezulton se është paraqitur në datë 06.10.2018 rreth orës 20:00 i shtruar me diagnozën “Lumbalgi” me

<sup>3</sup> Shkresa nr. K4/I19-3 datë 05.04.2023

<sup>4</sup> Shkresa nr. K4/I19-4 prot, datë 05.04.2023

<sup>5</sup> Shkresa nr. K4/I19-16 prot, datë 09.10.2023

<sup>6</sup> Shkresat nr. K4/I19-2 prot, date 05.04.2023, K4/I19-11 prot, datë 19.05.2023, K4/I10-13 prot, datë 16.08.2023

<sup>7</sup> Shkresa nr. K4/19-3 prot, datë 05.04.2023

<sup>8</sup> Shkresa nr. K4/I19-7 prot, datë 05.04.2023 dhe shkresa me nr. K4.I19-15 prot, datë 27.09.2023

numër regjistri 63356 pranë Qendrës Spitalore “Nënë Tereza” Tiranë, në kohën që ai ka qenë i arrestuar.

Në këto rrethana Institucioni i Avokatit të Popullit me shkresën nr. K4/I19-16 prot, datë 09.10.2023 ju drejtua Spitalit Universitar të Traumës nëse i paraburgosuri Renalt Tahiri është shoqëruar në këtë institucion për dhënien e ndihmës mjekësore dhe për të na vendosur në dispozicion kopje të kartelës mjekësore të këtij shtetasi.

Spitali Universitar i Traumës, me shkresën nr. 2700/1 prot, datë 13.10.2023 na informon se nga verifikimet e bëra në shërbimin e statistikës së SUT-së në regjistrat e urgjencës dhe indekset e statistikës, shtetasi Renalt Tahiri nuk rezulton të jetë regjistruar me datë 01.04.2023.

Pas vlerësimit të informacioneve dhe dokumentacionit të administruar nga Qendra Spitalore “Nënë Tereza” Tiranë (QSUT) dhe Spitali Universitar i Traumës (SUT), rezulton se i paraburgosuri Renalt Tahiri nuk është dërguar për në spital për dhënien e ndihmës mjekësore ku mund të merrte trajtim më të specializuar dhe mund të shpëtohej një jetë.

Instituti i Mjekësisë Ligjore me anë të shkresës me numër 7031/1 prot, datë 15.09.2023, na informon se në trupin e shtetasit Renalt Tahiri nuk u konstatuan dëmtime të jashtme trupore apo shenja të dhunës fizike. Në këqyrjen e brendshme dhe mikroskopikisht u konstatua vuajtje kronike e zgjatur e organeve vitale, vatra nekroze të indit kardik, bronkopneumoni e shoqëruar me gjendje septike me prekje multiorganore. Gjithashtu informohemi se sa u tha më lart shkaku i vdekjes së shtetasit Renalt Tahirit ka qenë pamjaftueshmëria e organeve vitale në terren të gjendjes septiko-piemike difuze të zgavrës së krahavorit dhe barkut.

Në përgjigje të shkresës tonë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë na informon se në bazë të materialeve të ardhura nga Komisariati i Policisë nr.3 Tiranë në lidhje me vdekjen e shtetasit Renalt Tahiri, me datë 12.04.2023 ka regjistruar kallëzimin penal nr.4341/2023. Në vijim, të përgjigjes të shkresës tonë të përsëritur për informacion të përditësuar, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me shkresën nr. 11361/1 prot, datë 20.10.2023 informon se procedimi penal me nr. 2866/2023 është në fazë hetimi dhe janë kryer disa veprime hetimore, si pyetja e shtetasve, këqyrja e marrjes së dokumentacionit etj, por nuk është administruar akoma akti i ekspertimit mjeko-ligjor nga mjekësia ligjore.

Në përfundim të hetimit të kryer në IEVP “Jordan Misja”, Tiranë dhe nga administrimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit përkatës në lidhje me ngjarjen e rëndë, ku si pasojë ka ndërruar jetë i paraburgosuri, shtetasi Renalt Tahiri, si dhe informacioni i dhënë nga institucionet përgjegjëse në lidhje me rastin në fjalë, konstatojmë se:

- ✚ Nga përmbajtja e librit të pritjes së të paraburgosurit në IEVP “Jordan Misja”, Tiranë, shtetasi Renalt Tahiri ndodhet në gjendje shëndetësore të rëndë dhe me dobësi trupore. Nga ana e Komisionit të Pritjes është bërë pranimi i të paraburgosurit pa marrë parasysh rrethanat shëndetësore në të cilat ndodhej shtetasi Renalt Tahiri<sup>9</sup>. Gjithashtu, stafi shëndetësor duhet të sugjeronte menjëherë shtrimin e tij në Qendrën Spitalore të Burgjeve që të ofrohej shërbim shëndetësor për diagnostikim, ekzaminim, dhe/ose trajtim të

---

<sup>9</sup> Në nenin 15, pika 1 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, thuhet se: “Menjëherë pas pranimin në institucion, i burgosuri i nënshtrohet një vizite ezaminuese dhe interviste mjekësore nga ana e mjekut dhe psikologut, me qëllim parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse në institucion apo vetëvrasjeve.

përqëndruar në spital, që nuk mund të ofrohej prej kujdesit shëndetësor parësor në IEVP, në përputhje me sistemin e referimit.

- ✚ Nga ana e Komisionit të Pritjes dhe mjekut të vizitës apo përgjegjësit të turnit nuk është parë e nevojshme koordinimi dhe vazhdimësia e kujdesit ndaj personit të paraburgosur që ka referuar probleme të rënda shëndetësore për trajtimin e tij në spital<sup>10</sup>, dhe sigurimin e një kujdesi sa më të mirë, në mënyrë që shërbimi shëndetësor i të gjitha niveleve të funksionojë në mënyrë të koordinuar, me qëllim mbulimin e nevojave shëndetësore, psikologjike dhe sociale.
- ✚ Shqetësimi i të paraburgosurit Renalt Tahirit ishte i drejtë dhe si i tillë duhet të vlerësohej nga ana e stafit të IEVP-së, me qëllim që në mundësitë e paraqitura të merreshin masat për kryerjen e ekzaminimit mjekësor të tij sa më parë. Rasti i këtij të paraburgosuri duhet të shikohet dhe vlerësohet në tërësinë e rrethanave të paraqitura që lidhen me gjendjen jo të mirë shëndetësore, kufizimin e lirisë, kushteve jashtë standardeve të ambienteve ku qëndrojnë të burgosurit në këtë institucion të cilat janë të njohura, dhe mandej detyrimin ligjor të organeve shtetërore për kujdesin shëndetësor të të dënuarve.
- ✚ Nga vlerësimi i informacioneve dhe dokumentacionit të administruar, të Qendrës Spitalore “Nënë Tereza” Tiranë (QSUT) dhe Spitalit Universitar të Traumës (SUT), rezulton se i paraburgosurit Renalt Tahiri nuk është dërguar për në spital për dhënien e ndihmës mjekësore ku mund të merrte trajtim më të specializuar dhe mund të shpëtohej një jetë.
- ✚ Nga mbikëqyrja rezulton se në dhomën nr. 4 të godinës A, sektori 1, kati parë, i paraburgosuri Renalt Tahiri ka qëndruar në një dhomë me kushte jo humane dhe degraduese, ku evidentohet lagështira tej normave të lejuara dhe për pasojë prezenca e saj në dhomën e banimit ka ndikuar drejtëpërdrejt në jetën dhe shëndetin e të paraburgosurit. Kjo tregon se stafi i IEVP-së nuk është treguar i kujdesshëm për ta dërguar me një dhomë me kushte të pranueshme banimi, duke qenë se gjendja shëndetësore e tij ka qenë e rënduar.
- ✚ Konstatohet se nuk është garantuar akomodimi i të dënuarve dhe të të burgosurve në mjedise të përshtatshme banimi, duke respektuar normat në minimum të hapësirës për person, në institucione të tilla, që janë 6m<sup>2</sup> për dhomat për një person dhe 4m<sup>2</sup> për person, kur në to sistemohen më shumë banorë.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit kushtetues e ligjor, në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63 të pikës 3 të Kushtetutës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, gërma “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive, si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*,

---

<sup>10</sup> Shih ligjin nr.81/2020, datë 25.06.2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, në nenin 41, pika 14 thuhet se raste urgjence, kur rrezikohet jeta e të burgosurit, ai transferohet për mjekim në Qendrën Spitalore të Burgjeve ose në institucionet e Kujdesit Shëndetësor Rajonal.

ku parashikohet midis të tjerash se: “*Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca:*b) *paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues*”.

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave për zbatimin me korrektësi e në zbatim të ligjit të procedurave lidhur me konstatimin e gjendjes shëndetësore të të paraburgosurve dhe ofrimin pa ndërprerje nën kujdesin dhe kontrollin e personelit mjekësor dhe shëndetësor, si dhe dërgimin e tyre në spital ku mund të marrin trajtim më të specializuar në regjimin spitalor dhe mund të shpëtohet një jetë.
2. Analizimin e rastit me hollësi nga strukturat kompetente të policisë, objekt i këtij hetimi administrativ dhe nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse, në funksion të një sjelljeje korrekte të Komisionit të Pritjes për pranimin e të burgosurve në IEVP “Jordan Misja”, Tiranë, dhe trajtimin e tyre sipas ligjit.
3. Përgjithësimin e këtyre rasteve në strukturat e Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve me qëllim mospërsëritjen në të ardhmen të shkeljes së të drejtave të personave të burgosur në trajtimin e tyre shëndetësor në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi, duke vlerësuar si primar jetën dhe shëndetin e të burgosurve.
4. Analizimin e këtij rasti dhe përgjithësimin i tij në të gjitha IEVP-të, në mënyrë që personeli policor, shëndetësor dhe ai social të vlerësojë më saktë rrezikun për gjendjen shëndetësore që paraqet një i burgosur, me qëllim ofrimin e shërbimit shëndetësor në mënyrë të koordinuar me Qendrën Spitalore për rastin në fjalë, si dhe atë psikologjike dhe sociale.
5. Marrjen e masave të menjëhershme, për përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare dhe eliminimin e lagështirës, për të garantuar akomodimin e të dënuarve dhe të të paraburgosurve në mjedise të përshtatshme banimi, duke respektuar normat në minimum të hapësirës për person, në institucione të tilla, që janë 6m<sup>2</sup> për dhomat për një person dhe 4m<sup>2</sup> për person, kur në to sistemohen më shumë banorë, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi dhe rekomandimeve të CPT për këtë qëllim.
6. Marrjen e masave të menjëhershme për zhvillimin e trajnimeve të nevojshme për stafet mjekësore dhe Komisionin e Pritjes dhe Pranimit për të verifikuar gjendjen e të burgosurit, si dhe diagnostikimin e tyre në kohë dhe me efektivitet.
7. Marrjen e masave për analizimin e shkaqeve për mos dhënie të deklaramit të saktë nga stafi i IEVP “Jordan Misja” Tiranë, për të garantuar ofrimin e shërbimit shëndetësor ndaj të paraburgosurit Renalt Tahiri në Qendrën Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë dhe nxjerrjen e përgjegjësive ligjore ndaj personave përgjegjës.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, kërkojmë të vihem në dijeni, brenda afatit 30 ditor, sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONER**

**Ahmet PRENÇI**